

12.10.2023
Ora 15:06

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar (Nuk është prezent)
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Ylli Merkaaj

Parti Politike: S’ka prezent

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme në orën 15:00. Në mbledhje janë të pranishëm katër anëtarë të Komisionit Rregullator, mungon anëtarja e komisionit zonja Helga Vukaj. Të pranishëm gjithashtu janë Sekretari i Përgjithshëm dhe zyrtarë të administratës së KQZ-së dhe zotëria përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile. Në mbledhje në rendin e ditës kemi vetëm një projektvendim “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”. Po pyes paraprakisht kolegët, nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Kolegë?! Nuk ka! Fillojmë me

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 12.10.2023*

projektvendimin, zoti Sekretar i Përgjithshëm, ju lutem në mënyrë të përmbledhur relacionin! Faleminderit!

Z. Y. Merkaj: Neni 20, pikat 2, shkronja “d” e Kodit Zgjedhor parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në shkallë vendi në përputhje me këtë ligj. Referuar nenit 167 të Kodit Zgjedhor, rezultati përfundimtar i zgjedhjeve shpallet nga KQZ-ja jo më vonë se 5 ditë nga data e shpalljes së rezultatit për shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, dhe pasi të kenë përfunduar procedurat e ankimit, sipas këtij Kodi. Në mbështetje të dekretit të Presidentit të Republikës, në datën 24 Shtator 2023 u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës. Bazuar në nenin 166, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse. Në mbështetje të nenit 33, të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11, ka shpallur fitues zotin Albert Bislim Halilaj, si kryetar të Bashkisë Kukës, të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 786, datë 4.10.2023 i ka dhënë mandatin kryetarit të Bashkisë Kukës, Qarku Kukës, zotit Albert Bislim Halilaj, të propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Komisioni Rregullator, pas dhënies së mandatit nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 20, pika 2, shkronja “d” dhe nenit 167 të Kodit Zgjedhor, shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Referuar për sa më sipër kemi përgatitur projektvendimin “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023”. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 12.10.2023*

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Sikundër dhe ju e theksuat, në datën 4.10.2023 është dhënë me vendim nga ana e Komisionerit, mandati i kryetarit të Bashkisë Kukës. Vendimi i Komisionerit kishte një afat tre ditë për ankimimin e tij, afat i cili është mbyllur ditën e hënë dhe prej këtij momenti, Komisioni Rregullator ka në dispozicion pesë ditë për të shpallur rezultatin.

Kolegë, kemi diçka në parim lidhur me projektaktin? Jo!

Kalojmë në votimin në parim të tij.

Kush është dakord?

Pro: 3 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka)

Kundër: 1 (z. Çakaj)

Miratohet me 3 vota pro dhe 1 kundër projektvendimi në parim!

Dua të theksoj se sipas nenit 20 ku janë kompetencat e Rregullatorit, ky është ndër dy aktet që mund të miratohet me shumicë të thjeshtë.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen.

Në mbështetje të nenit 20, pikat 2, shkronja “d”, e 3, dhe nenit 167, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator, vendosi:

Pika 1. Të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023, si më poshtë:

Zoti Albert Bislim Halilaj, kandidat fitues për kryetar të Bashkisë Kukës, Qarku Kukës, i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Kush është dakord?


Pro: 3 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka)

Kundër: 1 (z. Çakaj)

Me 3 vota pro dhe 1 kundër miratohet pika 1!

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 12.10.2023*

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 3 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka)

Kundër: 1 (z. Çakaj)

Me 3 vota pro dhe 1 kundër miratohet pika 2!

Pika 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 3 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka)

Kundër: 1 (z. Çakaj)

Me 3 vota pro dhe 1 kundër miratohet pika 3!

Znj. I. Nano: Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit dhe njëherë kolegë, dakordësinë tuaj, ose jo për projektvendimin në tërësi.

Kush është dakord?

Pro: 3 (znj. Nano, z. Çela, z. Çaka)

Kundër: 1 (z. Çakaj)

Miratohet me 3 vota pro dhe 1 kundër!

Meqenëse nuk kemi çështje të tjera në rendin e ditës, mbledhjen e deklaroj të mbyllur, faleminderit!

Vendim nr. 33

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU

